



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2023:023581
Datë: 15.02.2023
Numri i dokumentit: 03981840

Pml.nr.59/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Rasim Rasimi, kryetar i kolegjit, Afrim Shala dhe Valdete Daka, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Qefsere Berisha, procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të pandehurve Xh. M. dhe V. M., për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414, paragrafi 1. lidhur me paragrafin 2. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur lidhur me kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve: për të pandehurin Xh. M. avokati Driton Muharremi dhe për të pandehurin V. M. avokati Arian H. Hetemi, të paraqitura kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda PPRKR.nr.17/2023 të datës 24 janar 2023 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Krimeve të Rënda, PN.1.nr.108/2023 të datës 31 janar 2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 15 shkurt 2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Aprovohen si të bazuara kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësve të të pandehurve Xh. M. dhe V. M., e sipas detrës zyrtare edhe për të pandehurit K. S., L. D., D. G., I. J., E. E., Rr. O. dhe M. B., ndryshohen aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda PPRKR.nr.17/2023 të datës 24 janar 2023 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Krimeve të Rënda, PN.1.nr.108/2023 i datës 31 janar 2023, ashtu që të gjithë të pandehurve të lartëcekur iu ndërpritet masa e paraburgimit sot më 15 shkurt 2023, dhe të njëjtit lëshohen për t'u mbrojtur në liri.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktvendimin PPRKR.nr.17/2023 e datës 24 janar 2023, të pandehurve K. S., Xh. M., L. D., V. M., I. J., E. E., Rr. O., për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414, paragrafi 1 lidhur me paragrafin 2 të KPRK, ndërsa të pandehurit D. G. dhe M. B. veprën penale keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim nga nenin 415 paragrafi 2 të KPRK dhe veprën penale mashtrimi nga neni 333 paragrafi 5 të KPRK, ua ka caktuar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 1 (një) muaji, e cila masë sipas këtij aktvendimi do t'iu zgjasë nga data 23 janar 2023 deri më datën 23 shkurt 2023. Masa e paraburgimit iu është caktuar në bazë të nenit 191 paragrafi 1 lidhur me nenin 187, paragrafi 1., nënparagrafi 1.1., dhe 1.2., pika 1.2.2., e 1.2.3., të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktvendimin PN.1.nr.108/2023 e datës 31 janar 2023 i ka refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të pandehurve K. S., Xh. M., L. D., V. M., I. J., E. E., Rr. O., D. G. dhe M. B. dhe e ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë kanë ushtruar:

- mbrojtësi i të pandehurit Xh. M. avokati Driton Muharremi, për shkak të shkeljes së dispozitës së nenit 187, paragrafi 1., nënparagrafi 1.1., dhe 1.2., pika 1.2.2., e 1.2.3., shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 432 paragrafi 1 dhe 4 lidhur me nenin 384 paragrafi 2 pika 2.1 dhe 2.2 të KPP dhe për shkak të shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale të cilat shkelje kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësorë, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë kërkesën si të bazuar dhe të pandehurit t'ia ndërpres masën e paraburgimit dhe ta lirojë të mbrohet në liri; dhe

- mbrojtësi i të pandehurit V. M. avokati Arian H. Hetemi, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës penale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë kërkesën si të bazuar ashtu që vendimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rivendosije.

Kryeprokurori i shtetit, me shkresën KMLP.III.nr.26/2023 e datës 14 shkurt 2023, ka propozuar që kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësve të të pandehurve të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 paragrafi 1. lidhur me nenin 436 paragrafi 1. të KPP, vlerësoi pretendimet në kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, përgjigjjes në kërkesa dhe gjeti se:

- kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë janë të bazuara.

Në kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë mbrojtësit e të pandehurve theksojnë se të dy gjykatat gabimisht kanë vlerësuar bazat, kushtet dhe rrethanat ligjore lidhur me caktimin e masës së paraburgimit ndaj të pandehurve. Nuk kemi dyshim të bazuar se të pandehurit kanë kryer veprat penale për të cilat pandehen por vetëm është parafrazuar dispozita e nenit 187, paragrafi 1., nënparagrafi 1.1., po ashtu as bazat ligjore të nenit 187, paragrafi 1., nënparagrafi 1.1. dhe 1.2., pika 1.2.2., e 1.2.3., të KPP, nuk kanë arsye dhe mbështetje në prova. Të pandehurit nuk mund të ndryshojnë provat e as të ndikojnë në dëshmitarë apo njëri tjetrin e po ashtu as nuk kanë mundësi ta përsërisin veprën penale.

Sipas vlerësimit të kolegjit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet nga kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë janë të bazuara, ngase pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe kërkesave të mbrojtësve të të pandehurve, aktvendimet e kundërshtuara duhen ndryshuar dhe të pandehurit duhet liruar nga masa e paraburgimit, për arsye se këto aktvendime janë të paqëndrueshme, për çka me të drejtë tërheqin vërejtjen mbrojtësit në kërkesat e tyre.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se gjykatat e dy instancave më të ulëta gjyqësore nuk kanë dhënë arsyetim bindës dhe të qëndrueshëm përkitazi me bazat e paraburgimit. Përkatësisht nuk kanë analizuar në mënyrë ezauruese e reale motivet konkrete të pranimit të kërkesës, por më tepër kanë bërë përshkrim formal të shkaqeve dhe kritereve të parashikuara me ligj, duke mos precizuar mundësinë e asgjësimit, fshehjes, ndryshimit ose falsifikimit të provave të veprave penale si dhe mënyrën e ndikimit në dëshmitarë dhe në njëri tjetrin, rrethanat e cekura janë të karakterit abstrakt dhe pa mbështetje. Gjithashtu, duke vlerësuar arsyetimin e gjykatave respektive përkitazi me nenin 187, paragrafi 1., nënparagrafi 1.1., pika 1.2.3., të KPP, është evidente se arsyetimet janë të natyrës supozuese dhe pa mbështetje në prova konkrete, meqë rreziku i përsëritjes duhet të jetë i konkretizuar dhe i bazuar në prova konkrete dhe në asnjë rrethanë në të dhëna të pakonfirmuara.

Kjo Gjykatë vlerëson se pasi që sipas shkresave të lëndës, ekziston dyshimi i arsyeshëm se veprat penale janë kryer në vitin 2018, 2019, 2020, kontratat dhe të gjitha aktet përcjellëse të prokurimit si dhe procedurave tjera janë dokumente zyrtare dhe se gjenden në institucionin shtetëror në Komunën e Lipjanit, në polici, në prokurori dhe mundësia e ndikimit (apo falsifikimit) në këto raporte zyrtare është minore, ngase procedura penale është në zhvillim e sipër dhe janë duke u zhvilluar hetimet. Po ashtu, edhe mundësia e përsëritjes së veprave penale është abstrakte marrë parasysh se kontratat dhe kontrollimi teknik kanë përfunduar dhe mundësia e përsëritjes së veprës së njëjtë penale është prejudikuese.

Gjykata Supreme e Kosovës, me rastin e vendosjes posaçërisht ka pasur parasysh dhe ka aplikuar nenin 187 të KPP se: *“Paraburgimi caktohet ose vazhdohet vetëm kur përmbushen kushtet e paraparë me ligj (përveç dyshimit të bazuar edhe bazat e artikulueshme nga pikat 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të par.1.2 të nenit të lartcekur) dhe në rast se nuk përmbushen këto kushte (neni 165 paragrafi, 4.i KPP) i pandehuri apo e pandehura lirohet”,* që nga interpretimi logjik i kësaj dispozite mund të konkludohet se paraburgimi paraqet masën e fundit *“ultima ratio”* dhe e cila duhet të aplikohet vetëm përjashtimisht dhe nën kushte të përcaktuara dhe të argumentuara.

Duhet theksuar faktin se të pandehurve u ndërpritet paraburgimi si masë e sigurisë së prezencës së tyre dhe se ndaj tyre procedura penale vazhdon me fazat e saja, por të pandehurve u është mundësuar mbrojtja nga liria.

Përkundër faktit se të pandehurit K. S., L. D., D. G., I. J., E. E., Rr. O. dhe M. B., nuk kanë ushtruar kërkesa, kjo gjykatë vlerësoi se arsyet për të cilat ka marr vendim në dobi të pandehurve Xh. M. dhe V. M., shkojnë në dobi edhe të të pandehurve tjerë, të cilat nuk kanë parashtruar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, gjykata konform nenit 436, paragrafi 2. (beneficium cohaesionis) të KPP, vendosi edhe për këta të pandehur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga sa u parashtrua dhe në kuptim të nenit 438, paragrafi 1., nënparagrafi 1.1., të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2023:023581
Datë: 15.02.2023
Numri i dokumentit: 03981840

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
Pml.nr.59/2023, më 15 shkurt 2023

Bashkëpunëtorja profesionale
Qefsere Berisha

Kryetari i kolegjit,
Rasim Rasimi